



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë

Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine - Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade



# RAPORT VJETOR 2024

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë/Republika e Kosovës

Tel: +381 38 200 36 554

Web: [www.kipa.rks-gov.net](http://www.kipa.rks-gov.net)

## Përmbajtja

Hyrje .....	3
1. Pranimi i aplikimeve dhe kërkesave tjera nga palët .....	4
2. Ekzaminimi i aplikimeve / shqyrtimi i kërkesave .....	6
3. Kundërshtimet e regjistrimit të markës tregtare .....	10
4. Publikimi i Buletinit të Agjencisë .....	11
5. Digjitalizimi i API-së, Sistemi IPAS, WipoScan, WipoPublish dhe Web faqe .....	12
6. Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës .....	13
7. Udhëzuesit për ekzaminimin e objekteve të pronësisë industriale & Rregullore .....	14
8. Aktivitetet për promovimin e pronësisë industriale .....	15
9. Forcimi i kapaciteteve administrative të Agjencisë, takimet rajonale .....	20
10. Të hyrat financiare .....	23
11. Të arriturat kryesore .....	23
12. Donatorët .....	25
Kontakti .....	26

## Hyrje

Agjencia për Pronësi Industriale (API) është agjenci ekzekutive në kuadër të Ministrisë për Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti dhe është institucioni i vetëm i ngarkuar në Kosovë për administrimin dhe promovimin e të drejtave të pronësisë industriale, detyrim i cili buron nga neni i 46 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kjo agjenci është pika e vetme shtetërore në Kosovë për mbrojtjen e markave tregtare, patentave, dizajneve industriale, treguesve gjeografikë dhe topografive të produkteve të gjysmëpërçuesve. Përmes proceseve të regjistrimit, API siguron pronarëve të drejtat mbi pronësinë e tyre industriale, duke vepruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

API ka një rol kyç në zbatimin e Kapitullit VII të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit, ku Kosova angazhohet për të mbrojtur dhe zbatuar të drejtat e pronësisë intelektuale. Misioni kryesor i saj është të sigurojë mbrojtjen e pronësisë industriale në territorin e Republikës së Kosovës dhe të promovojë respektimin e kësaj lloji pronësie, duke u bazuar në legjislacionin vendas dhe praktikatat ndërkombëtare.

Në këtë raport vjetor, API paraqet detajet e punës së saj, sfidat me të cilat është përballur dhe përpjekjet për të rritur ndërgjegjësimin e publik rreth rëndësisë së pronësisë industriale në Kosovë. Me ndërgjegjësimin e rritur rreth rëndësisë së pronësisë intelektuale në tregun global, Agjencia është e përkushtuar të avancojë dhe të përmirësojë sistemin e pronësisë industriale në vend, duke përfshirë arritjen e objektivave strategjike.

Agjencia gjatë këtij viti ka fokusuar përpjekjet e saj në përfundimin e shqyrtimit të kundërshtimeve të markave tregtare dhe në zvogëlimin e kohës së regjistrimit të markave tregtare. Këto shërbime kanë pësuar përmirësime të ndjeshme, sipas raportit të mëposhtëm.

Ky raport i detajuar ofron një pasqyrë të hollësishme të lëndëve të pranuar, efikasitetit të stafit të Agjencisë, gamës së shërbimeve të ofruara, si dhe aktiviteteve që janë ndërmarrë për të forcuar kapacitetet administrative dhe promovimin e pronësisë industriale në Kosovë.

Duke ju dëshiruar vit të mbarë

JU FALENDEROJMË

## 1. Pranimi i aplikimeve dhe kërkesave tjera nga palët


Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar me angazhimin e saj në pranimin e kërkesave për objekte të pronësisë industriale, përfshirë Markat Tregtare, Patentat, Dizajnet Industriale, kundërshtimet e markave të publikuara, hulumtimet e markave tregtare, ekzaminimet paraprake, vazhdimet e markave tregtare, ndryshimet në regjistër, kërkesat mirëmbajtjen e patentave, dokumentacionet e përparësisë, autorizimet e përgjithshme, ankesat në komisionin e ankesave, vendimet e komisionit të ankesave dhe dokumentacionet tjera.

Në këtë periudhë kohore, në zyrën e pranimin të dokumentacionit të API-së, janë regjistruar **7394** kërkesa të ndryshme, të cilat janë analizuar dhe reflektuar në tabelën e mëposhtme:

<b>Tabela e kërkesave të pranuar për vitin 2024</b>	
Marka Tregtare aplikime	<b>2171</b>
Patenta aplikime	<b>11</b>
Dizajn Industriale aplikime	<b>65</b>
Kërkesa për vazhdime të markave tregtare	<b>832</b>
Kërkesa për ndryshime në regjistër të markave tregtare, patentave dhe dizajnëve industriale	<b>891</b>
Kërkesa për plotësime të Markave Tregtare, taksa për lëshimin e vendimit dhe taksa për lëshimin e certifikatës për Marka Tregtare, pagesa të patentave dhe dizajnit industrial	<b>2004</b>
Kërkesa për ekzaminimin e parakohshëm të markave tregtare	<b>24</b>
Autorizime	<b>85</b>
Kërkesa për mbajtje në fuqi të patentave	<b>121</b>
Kundërshtime të Markave Tregtare	<b>74</b>
Kërkesa për heqje dorë të markave tregtare dhe patentave	<b>36</b>
Kërkesa për ekstrakt regjistri	<b>11</b>

Kërkesa për vazhdimin e dizajnit industrial	<b>10</b>
Dokumente prioriteti	<b>98</b>
Kërkesa për informacione të markave tregtare dhe patentave	<b>74</b>
Mirëmbajtje vjetore të licencës së përfaqësuesve	<b>34</b>
Ankesa kundër vendimeve të API-së	<b>57</b>
Vendim i komisionit të ankesave	
Kërkesa për rivendosje të MT	<b>24</b>
Kërkesa nga pala dhe kërkesa për përmirësimin	<b>281</b>
Vërejtje kundër markës së publikuar	<b>5</b>
Kërkesë për shfuqizim vendimi dhe revokim	<b>10</b>
Dokumenti i ri	<b>383</b>
Përgjigje në kërkesën për kundërshtimin e MT	<b>70</b>
Kërkesë për kufizimin e listës së produkteve dhe shërbimeve	<b>10</b>
Kërkesë për licencë të markës tregtare dhe regjistrim pengu	<b>6</b>
Tërheqje të kundërshtimit të markave tregtare	<b>3</b>
Vendime të Gjykatës	<b>4</b>

*Tabela 1. Numri i dokumenteve hyrëse, Dhjetor 2024*




## 2. Ekzaminimi i aplikimeve / shqyrtimi i kërkesave

### Patenta

Numri i aplikimeve për patenta është ende në një nivel të ulët, kryesisht për shkak të mos-anëtarësimit të Kosovës në Zyrën Europiane të Patentave (EPO). Nëse Agjencia anëtarësohet në EPO, pritet të shihet një rritje e numrit të aplikimeve për patenta, pasi kjo do të reduktojë koston dhe kohën e procesit të aplikimit në krahasim me procedurat aktuale të mbrojtjes në nivel kombëtar në Kosovë.

Për çështjen e ekzaminimit të kërkesave për patenta, ky proces zhvillohet brenda 18 muajve nga data e paraqitjes së kërkesës. Pas marrjes së patentës, pronari i saj duhet të ofrojë një dëshmi shkrimore që shpikja e tij është e re dhe ka hap shpikës, duke filluar nga fundi i vitit të nëntë të afatit të patentës.



Njoftim për plotësimin e aplikacioneve për patentë	<b>1</b>
Njoftim për pagesën e tarifave për lëshimin e vendimit për njohje	<b>3</b>
Vendim për njohjen e patentës	<b>3</b>
Vendim të tërësishme – pjesërisht të patentave	<b>2</b>
Vendime për ndryshim në regjistër të patentave	<b>1</b>
User doc acceptance, pranimi i mbajtjeve në fuqi pas kontrollimit, dhe i dokumenteve tjera përcjellëse të hyra si user dokumente për aplikimet dhe regjistrin e patentave	<b>121</b>
Mbatje në fuqi të kontrolluara dhe chekuara	
Vendime për refuzimin e patentave	<b>2</b>

*Tabela 2. Statistika vjetore të sektorit të patentave 2024*

### **Marka Tregtare**

Numri i aplikimeve për marka tregtare është rritur me **17.66%** krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa aplikimet vendore kanë shënuar një rritje prej **13.61%**. Kjo rritje në aplikimet për marka tregtare nga pronarët vendorë dëshmon se aktivitetet e Agjencisë për promovimin e rëndësisë së mbrojtjes së pronësisë industriale kanë dhënë rezultate konkrete dhe të matshme.

Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar me përpunimin dhe shqyrtimin e kërkesave për marka tregtare. Deri tani, shqyrtimet e aplikimeve paraprake janë kompletuar me sukses, dhe puna vazhdon me të njëjtin dinamizëm për të shqyrtuar aplikimet e reja të markave tregtare që janë pranuar gjatë vitit 2024.


Me rritjen e numrit të publikimeve dhe ekzaminimeve për marka tregtare, është zvogëluar koha e regjistrimit të markave tregtare, pra marka tregtare më numër 1/2024 është regjistruar për një kohë më të shkurtë se marka tregtare 1/2023, ka pasur një zvogëlim të kohës për 46.31% apo 226 ditë.

Deri tek regjistrimi i një marke tregtare e cila nuk pranon kundërshtim gjatë publikimit, Agjencia duhet të ndjekë disa hapa, si: ekzaminimi formal i aplikacionit për markë tregtare, ekzaminimi lidhur me bazat absolute të refuzimit, publikimi i aplikimit, lëshimi i ftesës për pagesën e regjistrimit dhe në fund lëshimi i vendimit dhe certifikatës për regjistrimin e një markë tregtare.

Regjistrimi i një marke tregtare në Agjenci për aplikimet të cilat nuk pranojnë kundërshtime bëhet në kohë relativisht të shpejtë. Agjencia ka arritur të zvogëlojë kohën e marrjes së vendimit për

regjistrimit të markave tregtare. Tashmë pas pagesës së taksës, vendimi për regjistrim tërhiqet nga pala mbrenda 1 jave. Për markën me numër regjistrimi 20000 janë dashur 6 muaj të procedohet me vendimin pas pagesës, ndërsa për markën tregtare me numër regjistrimi 34145 janë dashur 3 ditë pune.

Është regjistruar përherë të parë marka multimediale në Kosovë. Ndryshimi në ligjet e pronësisë industriale gjatë vitit të kaluar ka mundësuar regjistrimin dhe mbrojtjen e markave multimediale në Kosovë, duke lehtësuar kështu mbrojtjen ligjore të shenjave të reja dhe kreative që reflektojnë zhvillimet moderne teknologjike dhe tregtare. Kjo përfshirje e markave multimediale në regjistrin e markave tregtare jo vetëm që rrit nivelin e mbrojtjes për pronarët e markave, por edhe promovon një mjedis më inovativ dhe dinamik për bizneset dhe konsumatorët.



Vendime për regjistrimin e markave tregtare	<b>2188</b>
Publikime të markave tregtare pas ekzaminimit	<b>1844</b>
Njoftime për plotësimin e aplikacioneve	<b>37</b>
Njoftime për heqje dorë të markave tregtare	<b>21</b>
Njoftim për refuzimin e aplikacioneve në baza absolute	<b>200</b>
Vendime për ndryshimin në regjistër të markave tregtare dhe përfaqësuesve të autorizuar	<b>867</b>
Njoftime për ndryshime të përfaqësuesit	<b>162</b>
Vendime për vazhdimin e markave tregtare	<b>911</b>
Lëshimi i certifikatave për marka tregtare	<b>1980</b>
Ftesë për pagesën e vendimit për markë tregtare	<b>1808</b>
Informacione në regjistër	<b>4</b>
Ekstrakte regjistri	<b>11</b>



Vendime për refuzimin e MT	<b>258</b>
Ftesa për përgjigje në kundërshtimin e markave tregtare, shfuqizimeve dhe revokimeve	<b>102</b>
Vendime shqyrtimin e kundërshtimeve të markave tregtare	<b>323</b>

Tabela 3. Statistika vjetore të sektorit të markave tregtare për vitin 2024

Grafikoni i mëposhtëm tregon numrin e ekzaminimit të markave tregtare të objekteve industriale në vite, ku në krahasim me vitin 2023 kemi një rritje prej 6.28% të numrit të ekzaminimeve të markave tregtare




### **Dizajni Industrial**

Numri i aplikimeve për dizjane industriale mbetet i njëjtë në krahasim me vitin e kaluar, por kemi rritje të numrit të aplikimeve me pronar vendor. Me dizajn industrial mbrohet dukja e jashtme e produktit. Produkti duhet të ketë karakter individual dhe të jetë i ri në fushën përkatëse.

Njoftime për plotësimin e Dizajnit Industrial	<b>40</b>
Vendime për vazhdimin e Dizajnit Industrial dhe ndryshimin në regjistër	<b>19</b>
Vendime për regjistrimin e Dizajnit Industrial	<b>39</b>
Certifikata për Dizajnin Industrial	<b>3</b>
Ftese për pagesën e regjistrimit të Dizajnit Industrial	<b>47</b>
Vendime për refuzimin e Dizajnit Industrial	<b>2</b>

Tabela 4. Statistika vjetore të dizajnit industrial 2024



### **Përmbledhja statistikore e punës vjetore**

Agjencia për Pronësi Industriale ka vazhduar me shqyrtimin e kërkesave të palëve të pranura gjatë këtij viti, ku në këtë në bazë të kërkesave të pranura kemi rritje apo ulje të veprimeve në sistemin IPAS.

Nga të dhënat statistikore të nxjerra në sistemin IPAS del se zyrtarët e API-së gjatë vitit 2024 kanë kryer gjithsejti **29103** hapa në sistem. Hapat përfshijnë kalimin nga një procedurë e ekzaminimit në procedurën tjetër.


Gjatë këtij viti janë skanuar, indeksuar dhe dërguar në server **15661** shkresa hyrëse dhe dalëse, që e bën procesin e pranimit dhe lëshimit të dokumenteve të nga forma elektronike shume me te lehte dhe shpejte.

Janë lëshuar **8716** dokumente dalëse, vendime, certifikata, ftesa, për përfundimin e proceseve të shqyrtimit të aplikimeve.

### **3. Kundërshtimet e regjistrimit të markës tregtare**

Shqyrtimi i kërkesave për kundërshtimin e markave tregtare ka vazhduar dhe gjatë këtij viti, ku Agjencia për Pronësi Industriale ka rritur numrin e kërkesave të shqyrtuara edhe pse me staf më pak në sektorin e kundërshtimeve. Gjatë këtij viti Agjencia ka filluar me shqyrtimin e përgjigjeve në kundërshtimin e markave tregtare të pranuar gjatë vitit 2024, përjashto lëndët për të cilat janë duke u zhvilluar procese në Gjykata të cilat sipas UA mbeten të pezulluara.

Nga tabela mëposhtme vërehet se kemi një rritje prej **31.30%** të kundërshtimeve të shqyrtuara më shumë se vitin paraprak. Pra Agjencia ka pasur fokusin e saj në përfundimin e këtyre lëndëve të mbetura nga vitet paraprake.



#### **4. Publikimi i Buletinit të Agjencisë**

Agjencia për Pronësi Industriale gjatë këtij viti ka publikuar 8 Buletine Zyrtare me 4397 objekte të pronësisë industriale të cilat përfshijnë: aplikime të markave tregtare, vendime për regjistrimin e markave tregtare, ndryshimet në regjistër, vazhdimet e markave tregtare, regjistrimet e patentave dhe dizajnit industrial.

Duke u mbështetur në buletin, pronarët e markave të mëhershme të cekur në nenin 34 të Ligjit për Marka Tregtare Nr. 08/L-075 mund të paraqesin kundërshtimet e tyre. Këto kundërshtime duhet të dorëzohen brenda periudhës kur Buletini Zyrtar është i hapur apo brenda 3 muajve nga data e publikimit të Buletinit Zyrtar.

Përveç Buletinit, Agjencia në ueb faqen e saj publikon dhe regjistrin online ku publiku mund të kërkojë për objekte të pronësisë industriale dhe aplikuesit mund të shikojnë procesin e shqyrtimit të aplikacionit të tyre.

Linku për qasje në Buletinet Zyrtare të Agjencisë <https://kipa.rks-gov.net/page.aspx?id=1,47>




## 5. Digjitalizimi i API-së, Sistemi IPAS, WipoScan, WipoPublish dhe Web faqe

Gjatë vitit 2024, Agjencia ka përgatitur planin “Digjitalizimi i Shërbimeve në Agjencinë për Pronësi Industriale”. Ky plan është miratuar nga ASHI dhe është dërguar tek WIPO (Organizata Botërore për Pronësi Intelektuale) për zbatim. Plani përfshin përditësimin e softuerit aktual IPAS, duke ofruar shërbime më efikase në veprimtarinë e punës dhe përmirësuar cilësinë, shpejtësinë, si dhe lehtësuar marrjen e shërbimeve nga palët. Marrëveshja me WIPO përfaqëson një arritje të madhe për Agjencinë, pasi kemi siguruar një pako softuerike pa kosto buxhetore.

Agjencia ka parapara në Planin Kombëtar për Zhvillim implementimin e aplikimeve online për objektet e pronësisë industriale gjatë vitit 2027. Përditësimi i softwarit gjatë vitit 2025 dhe plani për implemetimin e aplikimeve online do të paraprijnë instalimit të komponentës online. Aplikimet online do të eliminojnë tërësisht kontaktin me palët dhe do të lehtësoje qasje në shërbimet e Agjencisë.

Për më tepër gjatë këtij viti ka vazhduar përditësimi i regjistrit online për objektet e pronësisë industriale. Ky regjistër përditësohet çdo ditë kalendarike. Sipas legjislacionit, markat tregtare publikohen nga momenti i aplikimit ndërsa patentat dhe dizajnet industri ale publikohen në regjistër vetëm pas regjistrimit dhe publikimit të tyre në Buletinin Zyrtar.



Ky sistem i ofruar nga WIPO mundëson që palët të bëjnë kërkime për marka tregtare dhe të shohin statusin e aplikimeve të tyre, kjo krijon transparence tek palët pasi ato mundën në çdo kohë të verifikojnë rrjedhjen e shqyrtimit të lëndës së tyre.

API gjatë vitit 2024 ka publikuar aktivitetet kryesore në web faqen e saj, janë krijuar **17** lajme dhe publikuar në web faqen <https://kipa.rks-gov.net/>

Për informimin e publikut për pronësinë intelektuale, është aktive dhe web faqja në të cilën janë të përmbledhura të gjitha informatat mbi pronësinë intelektuale, <https://www.pronesiintelektuale.com/sq> .

## 6. Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës

Me mbështetjen e projektit LuxDev, është përgatitur Udhëzuesi për Ekzaminimin e Aplikacioneve për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës. Ky dokument përmban elementet kryesore që një ekzaminues i Treguesve Gjeografikë në Agjencinë për Pronësinë Industriale duhet t'i kushtojë kujdes gjatë shqyrtimit të dokumenteve dhe procedurës për regjistrimin e një Treguesi Gjeografik..

Po ashtu gjatë këtij viti është realizuar dhe një trajnim për komisionin për vlerësimin e aplikacioneve për treguesit gjeografike, ku janë njoftuar mbi udhëzuesin e përgatitur dhe janë njoftuar me të gjeturat e ekspertit të angazhuar nga projekti LuxDev mbi aplikimet e ardhshme potenciale për tregues gjeografikë dhe emërtime të origjinës.

Sipas raportit të dorëzuar është rekomanduar që produkti i flijës të mbrohet si Specialitet i Garantuar duke ditur që Kosova ka një disaporë të gjëra, dhe me dëshirë të gjithë do të përdorni një recetë unike e cila do të kishte shije të njëjtë pavarësisht se në cilin vend, shtet, prodhohet. Kjo do të krijonte atë lloj shije e cila për këdo do të jepte aromë Kosove, aromë shtëpie të Kosovës. Po ashtu si rekomandim ka dalur dhe regjistrimi i Uji i Kllokotit si Tregues Gjeografikë.

Në mënyrë që të regjistrohen këtu dy produkte, duhet të fillohet procedura e aplikimit pranë API-së. Aplikimi nuk është kompetencë e API-së. Kërkesa, aplikacioni duhet të dorëzohet në API nga një grup prodhuesish, dy e më shumë prodhues, të cilat duhet t'i plotësojnë të gjitha kriteret si të përcaktuara në Ligjin për TGJ dhe aktet nën-ligjore.

Po ashtu është mbajtur trajnimi për sistemin e kontrollit të Treguesve Gjeografikë. Trajnimi u organizua nga projekti CMO. Agjencia u përfaqësua nga 2 zyrtarët të cilët janë pjesë e komisionin për shqyrtimin e aplikacioneve për Tregues Gjeografikë.

Me qëllim të forcimit të kapaciteteve në kuadër të Treguesve Gjeografikë dhe Emërtimeve të Origjinës, stafi i API-së mori pjesë në trajnimin një ditë ku u trajtua tema mbi treguesit gjeografikë dhe emërtimet e origjinës, trajnim i ofruar për gjyqtarët e Gjykatës Komerciale. Në këtë trajnim u prezantua sistemi i mbrojtjes së treguesve gjeografikë, procedura e regjistrimit dhe zbatimi i të drejtave të dalura nga vendimi për regjistrimin e treguesit gjeografikë.



## **7. Udhëzuesit për ekzaminimin e objekteve të pronësisë industriale & Rregullore**

Janë finalizuar 3 udhëzues për ekzaminimin e objekteve të pronësisë industriale dhe atë:

- Udhëzuesi për ekzaminimin e Markave Tregtare;
- Udhëzuesi për ekzaminimin e Dizajneve Industriale;
- Udhëzuesi për ekzaminimin e Patentave.

Miratimi i tre udhëzuesve për ekzaminimin e objekteve të pronësisë industriale është një hap i rëndësishëm drejt standardizimit dhe përmirësimit të procedurave brenda Agjencisë për Pronësi Industriale. Këto dokumente ofrojnë qartësi dhe udhëzime specifike për ekzaminuesit, duke siguruar një proces më të qëndrueshëm dhe të drejtë për të gjithë aplikuesit.

Me ndihmën e projektit LuxDev është përgatitur Udhëzuesi për shqyrtimin e kërkesave për Certifikata të Mbrojtjes Plotësuese. Kjo Certifikatë ofron mbrojtje shtesë vetëm për produktin mjekësor ose të mbrojtjes së bimëve që mbrohet nga një patentë bazë deri në pesë (5) vite pas përfundimit të afatit ligjor të vlefshmërisë së patentës.

Projekti LuxDev ka mbështetur draftimin e udhëzuesit të veçantë për përcaktimin e kriterëve për vlerësimin e markave të mirënjohura dhe me reputacion. Ky udhëzues do të jetë pjesë e udhëzuesit për marka tregtare.

**Është miratuar** Rregullore (ZKM) nr. 21/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë për Pronësi Industriale. Kjo rregullore parasheh shtimin e stafit të Agjencisë për përmirësimin e shërbimeve të saj dhe formimin e Divizionit Juridik dhe atij të Promovimit.


## **8. Aktivitetet për promovimin e pronësisë industriale**

Agjencia për Pronësi Industriale dhe Zyra për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta në kuadër të festivalit të librit vizituan këndin e librave në Dukagjini Bookstore. Në këtë aktivitet, Agjencia dhe Zyra janë angazhuar në shpërndarjen e materialeve informative dhe borxhura lidhur me të drejtat e pronësisë intelektuale, duke ofruar informacion të vlefshëm për autorët, botuesit dhe lexuesit. Vizita në Dukagjini Bookstore synon të nxisë ndërgjegjësimin dhe respektimin e të drejtave të autorit dhe pronësisë intelektuale në industrinë e librit.



Promovimi i pronësisë industriale në Radio Televizionin e Kosovës ka qenë një iniciativë e rëndësishme për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rëndësinë e pronësisë intelektuale në vend. Gjatë këtij fushate, janë transmetuar disa video edukative që trajtojnë tema të ndryshme, si rëndësia e regjistrimit të markave tregtare, mbrojtja e pronësisë industriale, dhe mënyra se si pronësia intelektuale mund të mbështesë zhvillimin e bizneseve lokale.

Është mbajtur punëtorja e organizuar nga CLDP - Departamenti Amerikan - Dhoma e Tregtisë "Punëtorinë për Luftimin e Piraterisë dhe Falsifikimit në Kosove". Në këtë morën pjesë të gjitha institucionet e zbatimit të ligjit, 16-18 Prill.



Agjencia për Pronësi Industriale dhe Sektori i IP së Doganës së Kosovës morën pjesë në debatin e organizuar nga kolegji UBT me temën "Të kuptojmë rëndësinë e Pronësisë Intelektuale (IP) në promovimin e inovacionit dhe kreativitetit, dhe të eksplorojmë lloje të ndryshme të IP-së dhe rëndësinë e tyre".





Agjencia për Pronësi Industriale në bashkëpunim me Universitetin “Isa Boletini” në Mitrovicë organizuar një ligjeratë për studentët e këtij universiteti mbi rëndësinë e pronësisë intelektuale. Studentët u njoftuan me objektet e pronësisë industriale dhe rëndësinë e mbrojtjes së tyre.



Në kuadër të aktiviteteve të cilat i paraprijnë festimit të Ditës Botërore të Pronësisë Intelektuale, Agjencia mori pjesë në ligjëraten për rëndësinë e Pronësisë Intelektuale (IP), mbajtur në Fakultetin Juridik i Kolegjit AAB. Tema e kësaj ligjërate ishte “Të kuptojmë rëndësinë e Pronësisë Intelektuale (IP) në promovimin e inovacionit dhe kreativitetit, dhe të eksplorojmë lloje të ndryshme të IP’së dhe rëndësinë e tyre”.



Agjencia për Pronësi Industriale mori pjesë në panelin e organizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë me temën “Pronësia Intelektuale: Kuptimi i ndikimit dhe rëndësisë së saj”.



Agjencia për Pronësi Industriale në bashkëpunim me Universitetin “Hasan Prishtina”, Fakultetin Juridik mori pjesë në ligjeratën me studentët e këtij universiteti mbi rëndësinë e pronësisë intelektuale. Studentët u njoftuan me objektet e pronësisë industriale dhe rëndësinë e mbrojtjes së tyre.



U mbajt Konferenca për shënimin e Ditëve të Pronësisë Intelektuale dhe Ditës Botërore të Inovacionit dhe Kreativitetit: “Rëndësia e inovacionit dhe krijimtarisë në ndërtimin e së ardhmes tonë të përbashkët”, 26 Prill.



U organizua punëtorja me temën “Sfidat dhe qasjet inovative në mbrojtjen dhe zbatimin e të Drejtave Pronësore Intelektuale në industrinë e botimit, medias, përmbajtjes audiovizuale dhe softuerit”. Në këtë punëtori morën pjesë përfaqësues nga institucionet vendore dhe organizatat përkatëse. Aktiviteti u strukturua në dy panele diskutimi, ku u theksuan sfidat dhe qasjet në mbrojtjen dhe zbatimin e të Drejtave Pronësore Intelektuale.



U mbajt sesiioni “Përmirësimi i mbrojtjes dhe zbatimit të drejtave pronësore intelektuale (DPI-ve) në fushën e arteve vizuale dhe performuese, dizajnit dhe shërbimeve krijuese”



Me mbështetjen e UNDP është krijuar një video informuese mbi rëndësinë e mbrojtjes së markës tregtare. Kjo video përcjellë një mesazh mbi përfitimet të cilat rrjedhin nga regjistrimi i brendit apo identitetit të biznesit tuaj përmes markës tregtare.


## **9. Forcimi i kapaciteteve administrative të Agjencisë, takimet rajonale**

Me organizimin e Drejtorisë së Pronësisë Industriale në Qendrën e Trajnimit të tyre është mbajtur trajnimi në fushën e patentave “Raporti kërkimor dhe Opinioni i shkruar”, ku zyrtari i patentave ka marrë pjesë online në këtë trajnim.



Takimi i organizuar nga LuxDev për shqyrtimin e kërkesave për Certifikatat e Mbrojtjes Shtesë të Patentave u mbajt për të përmirësuar aftësitë profesionale të stafit të Agjencisë për Pronësi Industriale.


Është mbajtur trajnimi online organizuar nga EUIPO për marka tregtare, në këtë trajnim u diskutua për “Mbrojtja e markave tregtare me ngjyrë të bardhë dhe zezë” dhe “Shkaqet relative, mundësia e konfuzionit”. Zyrtaret e Agjencisë morën pjesë përmes Drejtorisë së Pronësisë Industriale të Republikës së Shqipërisë.



Agjencia për Pronësi Industriale ka marrë pjesë në trajnimi për Inspektorët e Tregut për luftimin e shkeljeve të markave tregtare në Kosovë. Ky trajnim u organizuar nga LuxDev.

Është mbajtur trajnimi në Drejtorinë e Pronësisë Industriale të Shqipërisë me temën “Klasifikimi i Nicës, markat e mirënjohura dhe strategjia e komunikimit në lidhje me aktivitetet e promovimit të pronësisë industriale.” Ky trajnim ndihmon në rritjen e ekspertizës së stafit për administrimin e markave tregtare dhe zhvillimin e strategjive efektive për promovimin e pronësisë industriale.

Në webinarin e organizuar nga EUIPO zyrtarët e Agjencisë u njoftuan mbi "Praktika e zakonshme mbi aplikimet e markave tregtare të bëra me keqbesim (CP13)". Ky trajnim është i rëndësishëm në një kohë kur Agjencia është duke shqyrtuar kundërshtimet e markave tregtare, e ndër të tjera keqbesimi është pjesë e disa pretendimeve të palëve.



Në Prishtinë u mbajt një takim trepalësh me rëndësi të veçantë për bashkëpunimin rajonal në fushën e pronësisë industriale, me pjesëmarrjen e delegacioneve nga Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut. Takimi u organizua me ftesë të Agjencisë për Pronësi Industriale të Republikës së Kosovës.



Janë përgatitur modulet e trajnimit për zyrtarët e API-së, modulet për marka tregtare, moduli i përgjithshëm për pronësi intelektuale, moduli për të drejtën e autorit, moduli për dizajnet industriale, moduli për treguesit gjeografikë dhe moduli për patenta. Këto module do të përpunohen dhe dorëzohen në IKAP ( Institutin e Kosovës për Administratë Publike) për ti zyrtarizuar si module për trajnimeve e zyrtareve në fushën e pronësisë intelektuale.

Është miratuar projekti Zviceran për fushën e pronësisë intelektuale në Kosovë. Lidhur me këtë janë mbajtur disa takime, dhe është parashikuar ardhja e ekipit të projektit zviceran gjatë vitit 2025 për analizimin e gjendjes në Kosovë dhe përgatitjen e termave të projektit.

## 10. Të hyrat financiare

Agjencia realizon të hyra të cilat gjatë kësaj periudhe raportuese kanë qenë në shumën **344,023.50** euro. Për realizimin e këtyre të hyrave janë gjeneruar 6470 fletëpagesa. API ka sistemin e saj online të gjenerimit të fletëpagesave përmes web faqes së saj, ky shërbim ka mundësuar zvogëlimin e kohës për aplikimin dhe qasje në shërbimet e API-së.



## 11. Të arriturat kryesore

- Finalizimi i Udhëzuesve për ekzaminimin e objekteve të pronësisë industriale:** API ka finalizuar draftimin e 3 udhëzuesve për ekzaminimin e objekteve të pronësisë industriale, këto udhëzues do të standardizojnë procedurat e ekzaminimit duke garantuar cilësi dhe vendime të drejta.
- Rritja e numrit të ekzaminimit dhe zvogëlimi i kohës së regjistrimit:** Numri i ekzaminimeve të markave tregtare është rritur, dhe i kombinuar me rritjen e numrit të publikimeve, kjo ka çuar në zvogëlimin e kohës së regjistrimit të objekteve të pronësisë industriale. Si rezultat, marka 1/2024 është regjistruar për një kohë më të shkurtër se marka tregtare 1/2023, me një **zvogëlim** të kohës prej **46.31%**, ose 226 ditë më pak.

3. **Përmirësimi i procesit të marrjes së vendimit për regjistrimit e markave tregtare:** është zvogëluar koha e marrjes së vendimit për regjistrimit të markave tregtare. Tashmë pas pagesë së taksës, vendimi për regjistrim tërhiqet nga pala mbrenda 1 jave. Për markën me numër regjistrimi **20000** janë dashur 6 muaj të procedohet me vendimin pas pagesës, ndërsa për markën tregtare me numër regjistrimi **34145** janë dashur 3 ditë pune.
4. **Rritja e numrit të vendimeve për zgjidhjen e kundërshtimeve të markave tregtare:** progres i lartë është shënuar në rritjen e numrit të vendimeve për zgjidhjen e kundërshtimeve të markave tregtare. Krahasuar me vitin e kaluar, kemi **30.89%** më shumë lëndë të zgjidhura. Aktualisht, Agjencia është duke shqyrtuar kundërshtimet e pranuar gjatë vitit 2024, duke eliminuar pritjen prej 10 vitesh për shqyrtimin e tyre.
5. **Digjitalizimi i Agjencisë për Pronësi Industriale:** Plani për digjitalizimin e shërbimeve të API-së është përgatitur dhe miratuar nga ASHI, duke hapur kështu rrugën për implementimin e softuerit të ri dhe planifikimin për pranimin online të aplikimeve me mbështetjen e WIPO (Organizata Botërore e Pronësisë Intelektuale).
6. **Përgatitja e udhëzuesve për treguesit gjeografikë dhe emërtimeve të origjinës:** API ka përgatitur Udhëzuesi për Ekzaminimin e Aplikacioneve për Treguesit Gjeografikë dhe Emërtimet e Origjinës dhe janë identifikuar 2 produkte potenciale për mbrojtje sipas Ligjit për Treguesit Gjeografikë, Uji i Kllokotit si Tregues Gjeografike dhe Flija si specialitet tradicional.
7. **Marrëveshja teknike me EUIPO:** Për herë të parë në historinë e saj Agjencia për Pronësi Industriale është dakorduar për një marrëveshje teknike me një institucion evropian të pronësisë intelektuale siç është EUIPO (Zyra e Pronësisë Intelektuale të Bashkimit Evropian), nënshkrimi i saj pritet në muajt në vazhdim.
8. **Përgatitja e moduleve për trajnimin e zyrtarëve të API-së:** janë përgatitur 6 module për trajnimin e zyrtarëve në fushën e pronësisë intelektuale. Këto module do të dërgohen për miratim në IKAP duke bërë pjesë e korrikulave për trajnimin e zyrtarëve në fushën e pronësisë intelektuale
9. **Është miratuar projekti Zviceran për mbështetjen e pronësisë intelektuale në Kosovë:** API ka iniciuar projekti Zviceran për mbështetjen e pronësisë intelektuale i cili ka për qëllim forcimin e kapaciteteve të institucioneve të Kosovës në këtë fushë, ky projekt është miratuar në dhe zbatimi i tij do të filloj vitin tjetër.
10. **Marrëveshja me EFTA:** API ka kontribuar në finalizimin e pjesës së pronësisë intelektuale në Marrëveshjen e Tregtisë së Lirë ndërmjet Kosovës dhe vendeve anëtarë të EFTA;
11. **Forcimi i kapaciteteve administrative:** janë realizuar disa trajnime për forcimin e kapaciteteve të zyrtarëve të Agjencisë, duke bashkëpunuar dhe me EUIPO-n në realizimin e tyre.
12. **Promovimi i pronësisë industriale:** janë realizuar një sërë aktivitete promovuese me biznese dhe studentë, përfshirë sesione informuese, ku pjesëmarrësit u njohën me rëndësinë e mbrojtjes së pronësisë industriale.



13. **Regjistrimi i markave jokonvencionale:** është regjistruar marka e parë multimediale në Kosovë. Ndryshimi në ligjet e pronësisë industriale gjatë vitit të kaluar ka mundësuar regjistrimin dhe mbrojtjen e markave multimediale në Kosovë, duke lehtësuar kështu mbrojtjen ligjore të shenjave të reja dhe kreative që reflektojnë zhvillimet moderne teknologjike dhe tregtare.
14. **Është miratuar** Rregullore (ZKM) nr. 21/2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të Agjencisë për Pronësi Industriale. Kjo rregullore parasheh shtimin e stafit të Agjencisë për përmirësimin e shërbimeve të saj dhe formimin e Divizionit Juridik dhe atij të Promovimit.

## 12. Donatorët

Gjatë këtij viti Agjencia për Pronësi Industriale është mbështetur nga disa donator përmes programeve të tyre:

1. UNDP;
2. LuxDev.

## Kontakti



Agjencia për Pronësi Industriale  
Agencija za Industrijsku Svojину  
Industrial Property Agency

MINISTRIA E INDUSTRIISË, NDËRMARRËSISË DHE TREGTISË

Adresa: Rruga "Arbënor e Astrit Dehari" nr. 21, 10000 Prishtinë / Republika e Kosovës

Website: [www.kipa.rks-gov.net](http://www.kipa.rks-gov.net)

E-mail: [infoapi@rks-gov.net](mailto:infoapi@rks-gov.net)

Tel: +383 38 200 36 554

Orari i pritjes: E hënë – E premte 08:00 - 16:00